


REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIJE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	<u>Z-D/DPK</u>	Br. Prot.	<u>01-115/2013</u>
Nr. i faq.		Prot No.	
Broj stranica	<u>02</u>	Data	
Nr. pages		Datum	<u>22-01-2013</u>
		Date	
PRISHTINË			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **27.12.2012**, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti** me Nr. AKK-03-2429/12, për ztr. **Hajdin Abazi** – Zavendës Ministër në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) në Qeverinë e Kosovës, **për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.**

**II. Rasti mund të rihapet** në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

**I. Pas zhvillimit të procedurës ligjore**, është konstatuar se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej nga rasti i shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-2429-12.

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-2429-12, për Zyrtarin e lartë, ztr. Hajdin Abazi – Zavendës Ministër në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), në të cilën është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht ka edhe funksion menaxhues në një biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit, konsiderohet papajtueshmëri funksionesh (Neni 15 , pika 1), zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, ztr.Abazi, ka kontaktuar zyrtarët e Agjencisë, dhe gjatë bisedës është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas kësaj bisede, zyrtari i lartë, ztr. Abazi ka deklaruar se, ka filluar procedurat për shmangien dhe parandalimin e konflikti të mundshëm të interesit.

Me datë 26.12.2012, ztr. Abazi ka sjellur në Agjencinë kundër Korrupsionit njoftimin dhe dokumentin e ri nga Agjensioni kosovar për regjistrimin e bizneseve (ARBK-së) me të cilin shihet se janë bërë ndryshimet e nevojshme për të shmangur ose parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit (DPK/DKI-03/4618-12).

Me këtë shkresë zyrtare konsiderojmë se është shmangur dhe parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

